


KONTAKT

DETAJ M21

2019





KONTAKT

A Ali Demi Str 40 Al - 1012 Tirana Albania
T +35542225338 **C** +355682029807
W mangalem21.kontakt.al **E** info@kontakt.al

Kontakt u themelua në vitin 1999 në Tiranë.

Forma Legale e Kompanisë:
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k)
NIPT: J921080006V
Kodi Fiskal: 3708169

Falë eksperiencës së gjatë në ndërtimet civile dhe rolit drejtues në treg, KONTAKT synon të jetë çdo herë zgjedhja e parë e klientit.

KONTAKT was established in 1999 with headquarters in Tirana.

Legal Form of Company:
Limited Liability Company (l.l.c)
NIPT/TIN: J921080006V
Fiscal Code: 3708169

KONTAKT has a long tradition in hard work and a can-do attitude. We are construction leaders in buildings and aspire to be your builders of choice.



RRETH NESH

About us

- 6 Rreth Nesh
- 7 Historiku

KONSTRUKSIONI

Construction

- 10 Sigurim Teknik
- 12 Viç
- 14 Gërmim
- 16 Përforcim Tabani
- 18 Pilota
- 20 Lëvozhgë
- 22 Hekur
- 24 Beton
- 26 Skela
- 28 Nënshtrësë
- 30 Muraturë
- 32 Suvatim
- 34 Fugë Sizmike
- 36 DysHEME Industriale

FASADA

Facade

- 40 Termoizolim
- 42 Lyerje
- 44 Dritare
- 46 Derë
- 48 Grilë
- 50 Parapet Xhami

TEKNIKA E SHTËPISË

Home Facilities

MEKANIKE • Mechanical

- 54 Ashensor
- 56 Shkallë
- 58 Derë Teknike
- 60 Derë Antizjarr
- 62 Derë e Brendshme
- 64 Kuti Poste
- 66 Sinjalistikë Rrugore
- 68 Tabelizim
- 70 Pllaka
- 72 Laminat
- 74 Baxhë
- 76 Davancalë Alumini

ELEKTRIKE • Electrical

- 78 Transformatori
- 80 Matësa Elektrik
- 82 Çelësa, Priza
- 84 Ndriçues Brenda
- 86 Ndriçues Jashtë
- 88 Telefon Tv Internet
- 90 Rrufepritës

HIDRAULIKE • Hydraulic

- 92 Uji Furnizim
- 94 Pompë Uji
- 96 Matësa
- 98 MKZ
- 100 Shkarkimi i Ujërave të Zeza
- 102 Ajërim
- 104 KUZ
- 106 KUB
- 108 Hidroizolim Nëntokë
- 110 Hidroizolim Tuatele
- 112 Hidroizolim Tarraca

SISTEMIMI I JASHTËM

External Accomodation

- 116 Rrugë Automjete
- 118 Rrugë Këmbësore
- 120 Lojëra
- 122 Fiskulturë
- 124 Biçikleta
- 126 Stola
- 128 Instalacion
- 130 Gjëlberim
- 132 Parkimi

Kontakt gëzon respektin si një ndër kompanitë inxhinierike të sukseshme në menaxhim projektesh, si edhe luan një rol kyç si gur themeli i inovacionit në industri.

Ne dhe klienti realizojmë së bashku projekte shumë të rëndësishme si: pasqyrim i arkitekturës bashkëkohore në Shqipëri, gjithashtu duke ndikuar në progres të qëndrueshëm dhe zhvillim të ekonomisë së vendit. Në 20 vite, kemi përfunduar më shumë se 70 projekte; disa prej tyre unikë, të shprehur deri tek përkushtimi në një punë të vazhdueshme, besimi dhe vlerat në gjithçka që bëjmë.

EKSPERTIZA JONË

1. Konstruksion:

Drejtimi primar i Kontakt si biznes në terma fitimi dhe të punësuarish. Ndërtim rezidencial, jorezidencial dhe civil.

2. Zhvillimi i rezidencave të banimit:

Kontakt nis, zhvillon dhe plotëson projektet rezidenciale me përparësi klientin si individ.

3. Zhvillimi i pronësisë komerciale:

Kontakt fillon, zhvillon dhe plotëson projekte komerciale, zyra, hapësira për dyqane dhe ambiente të tjera.

4. Tregu Imobiliar:

Kontakt ka zhvilluar tashmë një departament të ri në fushën e marketingut dhe të shitjes imobiliare. Ndërmjet një bashkëpunimi të fuqishëm me: arkitektë, fotografë, dizenjues, tashmë shitës imobiliarë, në një periudhë kohore relativisht shumë të shpejtë, duke përdorur teknikën e "Guerrilla Marketing".

SIGURI, CILËSI DHE ETIKË

Ndërtuar mbi vlera ekselence dhe integriteti të testuar në kohë, ne punojmë mbi standardet më të larta duke pasur si njësi matëse cilësinë në projekte, me synim kryesor konfirmimin vit pas viti si kompania më e sigurtë në tregun tonë. Jemi të vendosur të sjellim progres duke zhvilluar aftësitë lokale. Ne i ofrojmë kohën dhe talentin tonë komunitetit ku punojmë.

Kontakt is one of the most respected engineering, project management, and construction companies, and a cornerstone of innovation in the industry.

Together with our costumes, we deliver landmark projects - The modern marvels of Albania that foster sustainable progress and grow economies. Since 1999, we've completed more than 70 projects some of the first of a kind. We are a company grounded in hard work, integrity and trust, values integral to all we do.

OUR EXPERTISE

1. Construction

This is Kontakt's most significant business stream in terms of revenue and number of employees. Our business performs residential, non-residential, as well as civil construction.

2. Residential Development

Kontakt initiates, develops and invests in residential projects primarily on individual consumers.

3. Commercial Property Development

Kontakt launches expand, invests in and leases commercial property, projects, mainly office space, shopping malls, and logistics department.

4. Real-Estate Marketplace

Kontakt has recently established a new department in the field of marketing and real-estate. Through an active collaboration of architects, photographers, designers, real-estate agents and sales agents we can communicate the message that Kontakt transmits at a fast pace making use of the Guerrilla Marketing technique.

SAFETY, QUALITY, AND ETHICS

Kontakt is built upon time-tested values of excellence and integrity. And our primary goal is working to the highest ethical standards and being measured by the enduring quality of our projects. Year after year we are among the safest companies in our industry. We are committed to establishing progress by developing local skills for sustained economic opportunity and volunteering our time and talent to the communities where we work.



RRETH NESH ABOUT US


Kontakt ndërton kryesisht banesa në Tiranë. Projektin arkitekturë, konstruksion, elektrike dhe hidraulike. Shet produktet që ndërton dhe financon ndërtime të kompania bën. E krijuar në vitin 1999, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me një ortak të vetëm. Në 2019, Kontakt numëron 107 punonjës që menaxhojnë 300 punëtorë në ditë. Në Kontakt punën e sotme nuk e lëmë për nesër dhe kjo na cilëson si një kompani që absolutisht nuk bën kompromis me cilësinë që ofron, duke pasur gjithmonë parasysh se detajet e bëjnë diferencën dhe cilësinë. Motoja jonë është: “Ta bëjmë veten më të zhvilluar se dje!” dhe kjo moto praktikohet nga punonjësit e Kontakt, të cilët e dinë se të ndërtohet është më tepër sesa duket. Kompania jonë i qëndron mendimit se objektet duhet të jenë njësoj si ditën e parë të ndërtimit, ndaj aplikon një mirëmbajtje tejet serioze.

.....

Kontakt constructs especially buildings in Tirana. Projects architecture, construction, electrical, and hydraulic. Kontakt sells and funds the products that build and manufacture. Created in 1999, is a society with diminished responsibility with a single partner. In 2019 Kontakt has 107 employees that manage around 300 workers a day. With professionals like; Construction Engineers, Architects, Accountant, Lawyers, Designers and Sales Agents. In Kontakt, we don't leave today's work for tomorrow. Kontakt do not negotiate with quality and knows that the realization of the details makes the quality. Employers in Kontakt are aware that to build is much more than it seems, and walk ahead with the motto “To make themselves better than yesterday.” That's why Kontakt maintains its objects to make them look equal to the 1st day.



HISTORIKU HISTORY





KONSTRUKSI

KONSTRUKSIONI • construction

LIEBHERR

GÉLOER
CAO - STAND

RUAJI
NGA VINCI

SAFETY
FIRST

SAFETY
FIRST

SAFETY
FIRST

KUJDES

SIGURIM TEKNIK

Sigurimi teknik përfshin tabelizimin brenda dhe jashtë objekteve.


Këto tabela mundësojnë orientimin dhe sensibilizimin e qytetarëve për respektimin e rregullores gjatë lëvizjes në kantierin e ndërtimit. Ato pozicionohen në të gjithë kantierin për të lajmëruar dhe parandaluar rrezikun nga proceset e ndryshme të ndërtimit. Materialet e përdorura për realizimin e tyre janë metalike të fiksuara në strukturën e objekteve apo në strukturat rrethuese të kantierit.

.....

TECHNICAL INSURANCE

Technical insurance includes billboards inside and outside the facilities.

The site sign enable the orientation and awareness of citizens to respect the regulation during the work project of the construction period. They are placed throughout the site to alert and prevent the risk from various construction processes. The materials used for their realization are metal fixed in the structure of the objects or the surrounding structures of the site.



✓ SIGURIA NE KANTIER			
	Cdo vizitor duhet te raportoje te zyra e kantierit.		Jeleket mbrojtës janë te detyrueshem.
	Eshte i detyrueshem perdorimi i rripit te sigurimit per punimet ne lartesi.		Kepucet mbrojtëse janë te detyrueshme.
	Helmeta mbrojtëse është e detyrueshme.		KUJDES! Kantier ndertimi.
	KUJDES! Renie e objekteve nga lartesia.		KUJDES! Makineri te renda.
	Ndalohej rreptesisht hyrja ne kantier te personave te paautorizuar.		Femijet nuk duhet te luajne ne kete zone.

KUJDES
MJETE TE RENDA LEVIZESE


VINÇ

Mjetet e punës në një kompani ndërtimi janë faktori bazë për realizimin e proceseve, duke respektuar afate dhe cilësinë e kërkuar të punimeve. Vinçat si një prej këtyre mjeteve mundësojnë realizimin e proceseve të punës në një kohë më të shkurtër dhe me më shumë efikasitet.

.....

CRANE

Work tools in a construction company are the fundamental factor for the realization of processes while respecting the deadlines and required quality of the works. Cranes as one of these tools enable the recognition of working methods more shortly and efficiently.



GËRMIM

Bazuar në studimin gjeologjik ku janë realizuar 35 shpime në thellësinë 15 m, të cilat përfshijnë të gjithë themelet e Rezidencës "Mangalem 21", shtresat kryesore janë:


1. Tokë vegjetale: suargjila të mesme pak të ngjeshura, me ngjyrë kafe dhe lagështirë, plastike dhe të buta. Përmbajnë rrënjë bimësh dhe lëndë organike.
2. Suargjila të mesme deri të lehta, mesatarisht të ngjeshura, me ngjyrë bezhë në kafe dhe njolla gri me lagështirë. Përmbajnë shtresa surëre, plastike dhe sasi të vogël guralecësh.
3. Suargjila të mesme deri të rënda të ngjeshura, me ngjyrë bezhë në kafe dhe pak lagështirë. Përmbajnë plastike të forta dhe guralecë.
4. Argjila, alevrolite dhe ranore shumë të ngjeshura, në ngjyrë gri, me pak lagështirë dhe çimentim të dobët. Ujërat nëntokësorë në dimër takohen në thellësinë 4.2 m. Skarpatat e ilustruara në vizatim janë me kënd 45°. Rekomandohet që në fazën e parë të gërmimit të përfundojnë në distancën 175 cm, ose më shumë nga faqja e jashtme e themeleve të objekteve. Kuota e fazës së parë të gërmimit është ajo e nivelit të parë -15 cm.

.....

EXCAVATION

Based on the geological study where 35 drills in the depth of 15 m have, which include all the foundations of the "Mangalem21" residence, the layers of the first soil are:

1. Topsoil, soft light brown wet silty Clay, containing the root of plants and organic matters.
2. Firm beige to brown with black, brown, bluish, gray spots, moist silty CLAY to Clayey SILT
3. Very stiff to solid dark beige with some brown, black and gray spots. Slightly damp, silty Clay, containing a little gravel.
4. Very weathered to weathered weak dark gray Mudstone and Sandstone. The underground water level in the winter meets at depths of 4.2 m. The excavation phase based on three layers. The sketches shown in the drawing are 45° (1:1). The recommendation for the first stage end at a distance of 175 cm or more from the outer surface of the foundations of the objects. The first-stage quotation "quota" is the first-level quota of -15cm.



PËRFORCIM TABANI

Përforcimi dhe zëvendësimi i shtresave të dheut nën themele:


Duke qënë se sheshi ka pjerrtësi, tabani i themelit në truall haset me jo të njëjtat kushte fizike, diku arrin edhe mbi sipërfaqen natyrore. Si rast i përgjithshëm, në të gjitha themelet, para hedhjes së shtresës së varfër, vendoset një shtresë material i shkrifët, i rrulluar në jo më pak se 20 cm. Në bashkëpunim me inxhinierin gjeoteknik realizohet zgjedhja e materialit dhe përcaktimi i parametrave pas ngjeshjes. Meqënëse themelet janë me disnivele dhe lëvizja e ujit nëntokësor mund të shkaktojë sufozion, duhet që shtresave të shkrifta t'u paraprijë një shtresë pëlhere gjeoteknike, që shërben si pengesë për këtë fenomen.

.....

SUBSOIL REINFORCEMENT

Strengthening and replacing soil layers underneath the foundation.

As the slope is inclined, the foundation bed is placed under different soils conditions, somewhere on the natural surface as well. As a general case, on all foundations, before the throw-in of the weakest layer will be placed a material layer of not less than 20 cm rolled and compacted. The technical parameters of the materials after compression is carried out in cooperation with the geotechnical engineer. Since the foundations are disengaged and the underwater level movement can cause suffusion, it is necessary for the coarse layers to proceed with a geotextile layer that prevents this phenomenon.





PILOTA

Pilota me kafshim është një prej metodave më të përdorura për të mbështetur objektet në terrene me formacione të dobëta. Me një ngurtësi shumë më të madhe se pilotat e drurit, ato përdoren gjithashtu në rresht për t'u integruar në ndërtesën e ardhshme, si një mur në bodrum. Duke qëndruar në krahë të njëra-tjetrës, pilotat realizohen duke hedhur beton në zonat ku është bërë shpimi me sondë. Avantazhi i kësaj metode është se nuk shkakton shumë zhurmë gjatë punimeve, duke mos ndikuar në ndërtesat ekzistuese. Në rastin e pilotave me kafshim, gjatë zbatimit ndodh që ujërat nëntokësorë mund të depërtojnë përgjatë faqes së pilotave. Është i mundur minimizimi i rrjedhjeve me anë të shtresave drenazhuese, si "Delta Terrax", faqja e gjeotekstitit të së cilës vendoset anash pilotave për të realizuar funksionin e përcaktuar.

PILE FOUNDATION


Bored pile walls constitute a permanent method of shoring up vertical earth walls. Featuring a much higher bending stiffness than for example, timber walls, they are also used in the lining to be integrated into the future building, like a cellar wall, for instance. The cast of the site piles stand side by side, and the lining is made by filling the pre-drilled holes with concrete. In the presence of neighboring buildings, the advantage of this method is that it does not require pile drivers which generate a great deal of noise and vibration. Unless they overlap, bored pile walls are rarely waterproof so that seepage water may penetrate the lining across large surfaces; this seepage water may be drained away by a structural drainage layer such as Delta TERRAXX installed with the geotextile facing the pile wall.



KUJDES!

- KUOTIMI I PILOTES 1 DO TE BEHET NE CDO RAST DUKE IU REFERUAR KUOTES NE MAJE TE SAJ, E CILA DO TE JETE KUOTE E NIVELIT TE PARE TE OBJEKTIT FQINJE -4.8m.
- MODIFIKIMI BEHET VETEM SIPER NE FUNKSION TE LARTESISE SE PLLAKES SE OBJEKTIT, FITILAT E PILOTES DO TE JENE KUOTE PLLAKE -20CM.
- BETONI PER PILOTAT E ARMUARA KLASI C25/30.
- BETONI I PILOTAVE TE PAARMUARA KLASI C10/15.
- FRAKSIONI AGREGAT I BETONIT TE PILOTAVE TE ARMUARA NUK DUHET TE KALOJE 20 mm

-CELIKU fyP 5000 kg/cm², I SALDUESHEM.




LEVOZHGË

Punimet e kallëperisë horizontale dhe vertikale:

Kallëperia për strukturat beton-arme është një strukturë e përkohshme e cila montohet shpejt dhe mban ngarkesa të mëdha përgjatë kohës së hedhjes së betonit. Pajisja çmontohet pas arritjes së markës së betonit për përdorime të tjera. Objektivat primare në ndërtimin e kallëperisë janë: Cilësia - Qëndrueshmëria, rigjediteti, montimi dhe ruajtja e dimensioneve të elementeve që janë përdorur. Siguria - Përkon me sigurinë e strukturës dhe të punëtorëve të kompanisë. Ekonomia - Ruajtja e kostove në përputhje me kërkesat e cilësisë dhe sigurisë. Për të arritur këto qëllime është i domosdoshëm bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet inxhinierit/arkitektit dhe kontraktuesit. Synimi i Kontakt për strukturën beton-arme të objekteve në "Mangalem21" konsiston me realizimin e betoneve të pastra, për të cilat kryhet edhe bashkëpunimi i ngushtë me kompani lider në prodhimin e armaturave, si: "Paschal" dhe "Peri".

FORMWORK

Concrete Formwork and Vertical Formwork. Design Formwork is a classic temporary structure in the sense that it is erected quickly, highly loaded for a few hours during the concrete placement, and within a few days disassembled for future reuse. Primary objectives in form building are; Quality - In terms of strength, rigidity, position, and dimensions of the forms. Safety - For both the workers and the concrete structure. Economy - The least cost consistent with quality and safety requirements. Cooperation and coordination between engineer/architect and the contractor are necessary to achieve these goals. The main purpose for Kontakt in concrete reinforced elements of Mangalem21 is the realization of clean concrete surfaces, for which it cooperates closely with leading companies in the manufacture for formworks such as "Paschal" and "Peri".



HEKUR

Projektimi i strukturave beton-arme në objektet që Kontakt realizon janë të realizuara bazuar në Eurocode 2 (pr. EN 1992-1-1 Dec. 2003), Eurocode 3, Eurocode 8 dhe KTP N2-89.

Për çdo porosi hekuri të parapërgatitur që vjen në kantierin tonë, merren mostra të ndryshme për t'u testuar. Testet për kontrollin e cilësisë që realizohen në laboratorin e Kontakt dhe laboratorë të jashtëm janë:

1. Përcaktimi i zgjatimit relative.
2. Përbërja kimike.
3. Rezistenca në tërheqje.
4. Raporti këputje-rrjedhshmëri.

.....



STEEL REINFORCEMENT

Reinforced concrete design in Kontakt's buildings is calculated referring to Eurocode 2 (pr. EN 1992-1-1 Dec. 2003), Eurocode 3, Eurocode 8 and. KTP N2-89.

For every steel reinforcing bar delivered to our site, we test specimens from different bars.

The test for controlling the quality of the bars in our laboratory are:

1. The determination of mass per meter
2. Chemical composition
3. Tensile properties
4. Bend performance




BETON

Procesi i betonimit merr vëmendjen kryesore. Konfirmimi i realizimit të këtij procesi ndodh pasi kontrollohet cilësia në vepër, konsistenca dhe koha e përgatitjes së betonit për të siguruar konsolidimin e plotë dhe efektiv. Betoni kompaktohet plotësisht nëpërmjet vibrimit, ku vibratorët e brendshëm duhet të veprojnë në më shumë se 10.000 rpm, ndërsa vibratorët e jashtëm të montuar në beton vibrojnë në më shumë se 3.000 rpm. Pas arritjes së markës së betonit në ditën e 28-të, por edhe me konfirmimin e testeve të shtypjeve të kubikëve (15x15x15 cm), gjithashtu të testeve me sklerometër, fillon procedura e heqjes së beton formave.

REINFORCED CONCRETE

The concrete process is one of the primary method and before the placing sequence, rate and layer thickness is controlled to ensure that consolidation is sufficient and complete. The vibration is the system we used to fully compact the concrete. Internal vibrators (pokers) should operate at more than 10 000 rpm while external vibrators attached to the formwork should operate at more than 3 000 rpm. About the 28th-day cube strength, the concrete should satisfy the relevant requirements and after this start the procedure of taking the formwork off.





SKELA

Skelat Layher janë struktura të përkohshme për suportin e njerëzve dhe të materialeve, që ngrihen gjatë ndërtimit apo rikonstruksioneve në objektet tona në fasada apo për punime të brendshme. Me elementë të thjeshtë dhe projekt të detajuar punonjësit tanë të kualifikuar në montime skelerie, sigurojnë struktura të sigurta për të punuar, konform të gjithë rregullave të sigurimit teknik.

.....

SCAFFOLDING

Layher scaffolding is a temporary structure to support people and materials when constructing or repairing our buildings exteriors and interiors. With just a few essential elements and a very detailed project, our qualified operators provide a secure base for the work, according to the standards for health and safety on site.




NËNSHTRESË

Materiali me bazë rërë/çimento aplikohet në ambientet tokësore për mbulimin e instalimeve elektrike dhe hidraulike të vendosura në dysheme. Kjo shtresë respekton pjerrtësinë e përcaktuar nga projekti sipas ambienteve ku aplikohet, gjithashtu nuk krijon pluhura, nuk shkërmoqet, nuk përmban aromë, nuk digjet dhe nuk është korroziv. Përshtatet me çdo shtresë pasardhëse të saj si: laminat apo pllaka të çdo lloji.

.....

SUBSTRATE

Kontakt applies materials such as sand and cement based in overhead areas for covering electrical and hydraulic installations located on the floor. This layer respects the slope determined by the project according to the environment where it is applied. It does not produce powders, does not shrink, does not contain any flavor, does not burn and is not corrosive. This method refers to any subsequent layer such as laminate or tiles of any kind.




SUVATIM

Suva mbushëse me çimento-gëlqere, e cila përdoret për mure të brendshme, tavanë dhe fasada me ngarkesë të ulët lagështie. Trashësia e aplikimit është 8-10 mm. Fino është llaç i thatë i parapërzjerë dhe i hollë, për mure të brendshme mbi suvatim mbushës. Trashësia e aplikimit është 2-3 mm. Aplikohet me sprucim mbi sipërfaqen e suvatuar.

.....

INTERIOR PLASTER

Kontakt apply plaster with lime cement. Plaster, for interior walls, ceilings, and façades with low moisture load. Application thickness 8 -10mm. Beautiful is dry mortar thin for interior walls on filling plaster. Application thickness 2-3mm apply by spraying over the plastered surface.




FUGA SIZMIKE

Fugat sizmike janë të pozicionuara në hapësirën midis dy objekteve fqinje për të realizuar vazhdimësi funksionale dhe qëndrueshmëri nga ana konstruktive. Ato janë të projektuara për lëvizje sizmike shumë dimensionale. Struktura metalike pozicionohet horizontalisht duke u inkastruar në dyshemenë midis dy objekteve. Ky sistem është rezistent ndaj rrezeve UV, ozonit, shiut acid, kimikateve, si dhe temperaturave ekstreme.

.....

SEISMIC JOINT

Seismic joints are positioned in the space between two adjacent buildings to achieve functional continuity and constructive sustainability. They are designed for multi-dimensional seismic motion. The metal structure is placed horizontally by being incinerated on the floor between the two objects. This system is resistant to UV rays, ozone, acid rain, chemicals as well as extreme temperatures.




DYSHEME INDUSTRIALE

Kjo shtresë betoni aplikohet në ambientet nëntokë për mbulimin e pllakës së themelit.
Pas shtresës së betonit aplikohet një mbulesë kuarci inorganik dhe realizohet nivelim i dy shtresave.
DysHEMEja industriale është rezistente ndaj lagështisë dhe goditjeve mekanike, e përshtatshme më së miri për ambiente parkimi me levizje të shumta automjesh.

.....

INDUSTRIAL FLOOR

This concrete layer applied to the underfloor for covering the base plate.
After the solid layer, an inorganic quartz cover applied and two coats leveled. The industrial flooring is moisture resistant and mechanical shocks, best suited for parking spaces with multiple vehicles.







TERMOIZOLIM

Termoizolimi i fasadës realizohet me lesh guri me trashësi 70 mm të vendosur mbi muraturën 400 mm. Leshi i gurit është rezistent kundrejt agjentëve atmosferikë, zjarrit, ndotjes akustike dhe ndotjes së ajrit. Struktura poroze dhe e hapur, e përbërë nga fibra rezistente deri në temperaturë 1000° C, krijon një barrierë termike dhe akustike. Ky sistem siguron reduktim të konsumit të energjisë deri në 60% dhe siguri më të madhe teknike

ETICS

The thermal insulation of the façade made of 70 mm thick stone wool placed over the 400 mm masonry. Stone wool is resistant to atmospheric agents, fire, acoustic pollution, and air pollution. The porous and open structure made up of resistant fibers up to 1000° C, creates a thermal and acoustic barrier. This system provides a reduction of energy consumption up to 60% and greater technical security.




LYERJE

Termoizolimi i fasadës përfundon me një shtresë suvatimi me grimca 2 mm. Grafiato e përdorur për suvatimin e fasadës është e bardhë dhe në përfundim të sistemit aplikohet bojë sipas pigmentit të përcaktuar për secilën fasadë. Paleta e ngjyrave të fasadës përbëhet nga 25 pigmente të veçanta ngjyrash.

.....

PAINT

The thermal insulation of the façade finishes with a 2 mm particle coating layer. The graphite used for plastering the façade is white. At the end of the system, paint applied according to the pigment defined for each façade. The façade colors consist of 25 special pigments of color.





DRITARE

Dritare alumini termike përbëhet nga xham i dyfishtë dhe grila alumini me dimension standart 1770x1755 mm. Ngjyra e profilit të dritares në interior është e bardhë, ndërsa në eksterior është sipas paletës së ngjyrave, të përbërë nga 14 pigmente. Kombinim estetik dhe teknik i përsosur, për të siguruar harmoni me ngjyrat e fasadës, izolim termik, akustik dhe mbrojtje ndaj lagështisë.

WINDOW

Aluminum double glazed, aluminum window and aluminum grille with standard dimensions 1770x1755 mm. The color of the window profile in the interior is white, while the exterior is in the color palette consisting of 14 pigments. Perfect aesthetic and technical combination to ensure harmony with façade colors, thermal, acoustic and moisture proofing.




DERË

Dyer alumini termik me xham të dyfishtë me dimension 1770x2455 mm. Tre variantet e dyerve prej alumini termik të fasadës në katin përdhes janë: të hapshme, statike dhe me grilë të integruar për vendosjen e njësisë së kondicionimit. Ngjyra e profilit të dritares në interior është e bardhë, ndërsa në eksterior është sipas paletës së ngjyrave, të përbërë nga 14 pigmente. Kombinimi estetik dhe teknik i përsosur, për të siguruar harmoni me ngjyrat e fasadës, izolim termik, akustik dhe mbrojtje ndaj lagështisë.

.....

DOOR

Double door with 1770x2455 mm dimension is dual glazed thermal. There are three versions of thermal aluminum doors in the ground floor: open, static and integrated grilles for the installation of the air conditioning unit. The color of the window profile in the interior is white, while the exterior is in the color palette consisting of 14 pigments. Perfect aesthetic and technical combination to ensure harmony with façade colors, thermal, acoustic and moisture proofing.





GRILË

Një aksesori i rëndësishëm për dritaret e apartamentit janë dhe grilat. Grilat plastike që Kontakt ofron janë të thjeshta, me një dizajn minimalist të cilat ndihmojnë në ngrohjen e ambientit dhe kursimin e energjisë deri në 30%.

.....

WINDOW SHADES

An essential accessory to the apartment windows is window shades. Plastic Kontakt shades are simple, with a minimalist design that help to heat the environment and save energy up to 30%.







PARAPET XHAMI

Parapet xhami me profile alumini, me dimension i cili varion sipas lartësisë së çarjes në fasadë. Është i inkastruar në parapetin e betonit horizontalisht dhe në kolonat strukturale vertikalisht. Fiksimi i tillë i parapetit siguron qëndrueshmëri ndaj goditjeve mekanike dhe fushë vizive më të pastër. Ngjyra e profilit të parapetit është sipas paletës së ngjyrave, të përbërë nga 14 pigmente.

GLASS RAILINGS

Aluminum profiles with dimensions varying according to the height of the carv on the facade. It is incinerated in the concrete parapet horizontally and in structural columns vertically. Such parapet fixing ensures firmness to mechanical shocks and cleaner visual field. The color of the parapet profile based on the color palette consisting of 14 pigments.



0



	Mbani Pastër
	0121-0124



ASHENSOR

Ashensori është një nga pjesët më të rëndësishme në një objekt banimi. Kjo teknologji e përdorur, mundëson eko-efikasitet, komoditet, pamje tërheqëse dhe fleksibilitet në lëvizje. Sistemi ofron përmirësim të komoditetit duke arritur siguri dhe besueshmëri nga ana teknike nëpërmjet përshpejtimit të ngadaltë dhe nivelim të saktë të kabinës në çdo kat të objektit. Ky sistem siguron reduktim të lëkundjeve dhe minimizim të zhurmave gjatë lëvizjes.

.....

ELEVATOR

The elevator is one of the essential part of a residential building. This technology utilizes eco-efficiency, convenience, attractive appearance and flexibility in motion. The system offers improved comfort to achieve technical reliability through slow acceleration and precise leveling of the cab on each floor of the building. This system assures a reduction of tech generation and noise minimization during motion.




SHKALLË

Kafazi i shkallës është trajtuar si një zonë e veçantë e objektit. Muratura e suvatuar, kangellat prej metali dhe pllakat qeramike janë zëvendësuar me muraturë, shkallë dhe parapet të realizuara me beton të pastër, të trajtuara vetëm me primer për mirëmbajtjen e tyre. Ekspozimi në të tillë mënyrë i betonit të këtyre strukturave krijon mundësinë e trajtimit të tyre me një dizajn të veçantë dhe inovativ.

.....

STAIRS

Kontakt treats the staircase as a particular area of the object. Masonry, stairs and parapets realized with pure concrete replaced plastered masonry, metal beams and ceramic tiles, treated only with primer for their maintenance. Exposure to such concrete structures of these structures creates the possibility of their treatment with a unique and innovative design.





DYER TEKNIKE

Dyer alumini jo termik në ambiente teknike si depo uji dhe kabina elektrike. Me dy kanata të hapshme me dimension 800 mm, të veshura me grilë teknike me ngjyrë të bardhë. Dera do të vendoset mbi një prag betoni për arsye teknike, për shmangien e lagështisë së mundshme të këtyre ambienteve.

TECHNICAL DOORS

For technical environments such as water storage and electric cabins, we use non-thermal aluminum doors. With two folds opening with 800 mm dimension, coated with a unique and white color grille. The door will be placed on a particular threshold for technical reasons, to avoid the potential moisture of these environments.




DERË ANTIZJARR

Dyert antizjarr vendosen në hyrjen e shkallës. Profile metalike me sipërfaqe anti-gërvishtëse, mbushet me material termoizolues. Ky sistem siguron izolim termik dhe akustik, si dhe mbrojtje të ambienteve në rast zjarri. Ngjyra e dyerve do të jetë e bardhë në harmoni me interiorin e korridoreve dhe betonin e ekspozuar të shkallëve.

.....

FIREPROOF DOOR

Fireproof doors placed at the entrance of the staircase. Metal profile with an anti-gable face, filled with thermal insulation material. This system provides thermal and acoustic insulation as well as fire protection facilities. The color of the doors will be white in harmony with the interior of the corridors and exposed concrete of stairs.





DERË E BRËNDSHME

Dyert e drurit vendosen në ambientet e brendshme të njëjësive të banimit apo shërbimit. Panelet e drurit mbushen në brendësi me shirita tallashi me çarje cilindrike. Dimensionet variojnë sipas ambientit, ndërsa ngjyra e bardhë dhe pamja e thjeshtë e kthen derën në një mobilie të përshtatshme lehtësisht me interiorin e apartamentit, si dhe më të thjeshtë për t'u mirëmbajtur.

.....

INTERIOR DOOR

Wooden doors placed in the interior of the residential or service units. Wood panels filled with ribbed strips of cylindrical cracks. Dimensions vary by ambient, while the white color and the simple look turn the door into an item of furniture that is easy to fit with the interior of the apartment and is simple to maintain.




KUTI POSTE

Kutitë e postës janë të pozicionuara në korridorin hyrës të çdo objekti. Të vendosura në një lartësi të caktuar për t'u aksesuar nga çdo grupmoshë. Materiali metalik me sipërfaqe të trajtuar posaçërisht mundëson rezistencën ndaj korrozionit dhe jetëgjatësi në ambientet e përbashkëta të objektit. Ngjyra dhe dizajni i tyre është pjesë e interiorit të hyrjes në objekt.

.....

MAIL BOX

The mailboxes positioned in the entrance corridor of each object. Located at a certain height to be accessed by each age group. A metallic material with specially treated surfaces provides resistance to corrosion and durability in the shared premises of the facility. Their color and design is part of the interior of the entrance to the object.




SINJALISTIKË RRUGORE

Sinjalistika mbitokë që Kontakt ofron është në standardet bashkëkohore. Në këtë mënyrë, banorëve dhe vizitorëve nga jashtë kompleksit, u bëhet shumë më i lehtë orientimi përsa i përket hyrjes dhe numrave të shkallëve në objekt, falë tabelave orientuese në sistemimet e jashtme.

STREET SIGNAGE

The land-based signage that KONTAKT offers is in contemporary standards. In this way, residents and visitors from outside the complex are much easier to navigate concerning entry and staircase numbers on the outside of the orientation tables in the exterior system.

Sinjalistike vertikale



TABELIZIM


Tabelizimi përdoret për orientimin e banorëve brenda objektit. Gjithashtu funksionon për sensibilizimin e qytetarëve për rregullat bazë të ambienteve të përbashkëta, siç janë: “Mbani pastër ambientin!”, “Mos pini duhan!” etj. Në “Mangalem21”, përdorimi i tyre është shumë i veçantë, pasi vijnë me ngjyra të ndryshme, duke iu përshtatur kështu konceptit të projektit. Materiali i përdorur është forex, me trashësi 0.5 cm dhe montimi i tabelave realizohet me ngjitës biadeziv dhe ngjitës silikon.

.....


INDOOR SIGNAGE

Indoor signage used for the orientation of residents within the facility and It also works to raise citizens' awareness about the basic rules of shared facilities such as keeping the environment clean, do not smoke, etc. In Mangalem21, their use is extraordinary because they come in different colors by so adapted to the concept of the project. The material used is forex with a thickness of 0.5 cm. Their filling made with a bayesian adhesive and a silicone sealant.


Ndalohe Duhani



Mbani Paster



Shigjete Orientuese





PLLAKA

Pas aplikimit të nënshtrësës mbi soletë për mbulimin e instalimeve elektrike dhe hidraulike, realizohet shtrimi me pllaka qeramike me dimension 1200x600 mm. Ngjyra e pllakave kombinohet në mënyrë perfekte me interiorin e korridoreve ku do te aplikohen. Këto pllaka mirëmbahen lehtësisht, duke siguruar jetëgjatësi më të madhe për hapësirat e përbashkëta që kanë një fluks të madh lëvizjeje.

PAVEMENT TILES

After application of the substation on the soles for the covering of electrical and hydraulic installations realized ceramic tiles with dimension 1200x600 mm, the color of the tiles is easily combined with the interiors of the corridors where they will be applied. These tiles easily maintained by providing greater lifespan for the common spaces that have a significant flow of flux.




LAMINAT

Pas aplikimit të nënshtresës mbi soletë për mbulimin e instalimeve elektrike dhe hidraulike, në apartamente realizohet shtrimi me parket laminat. Laminati i përdorur mund të mirëmbahet dhe të përshtatet shumë lehtë me interiorin e ambientit ku do të aplikohet. Ngjyra e laminatit dhe batiskopit varion sipas preferencës së klientit. Kjo veshje për dyshemetë krijon ambiente të ngrohta dhe komode.

.....

LAMINATE

After the application of the substation on the soles for covering the electrical and plumbing installations, in the apartments is realized the laminate flooring. The laminate used can be easily maintained and adapted to the ambient environment where it will be applied. The color of the laminate and the skirting varies according to the client's preference. This floor covering creates warm and comfortable environments.




BAXHË

Baxha PVC në tarracë është pjesë e sistemit antitym të shkallës. Sipërfaqja e saj është transparente dhe hapet shumë thjesht, duke realizuar ndriçim natyral, ventilim dhe akses në tarracë. Ky sistem përshtatet me shtresat termo dhe hidroizoluese të tarracës, për të realizuar mbylljen e hapësirës së shkallës në mënyrën më të mirë të mundshme, si teknikiisht, ashtu edhe estetikisht.

.....

DORMER

The lace PVC in the lawn is part of the anti-smoke scale system. Its transparent and easy-to-open surface provides natural light, ventilation and access to the terrace. This system adapts to the thermal and watertight layers of the roof to realize the closure of the staircase in the best possible way both technically and aesthetically.





DAVANCALË ALUMINI

Davancali i aluminit është elementi i cili realizon bashkimin midis sistemit hidroizolues të tarracës dhe termoizolues të fasadës. Materiali dhe forma e tij e përshtatshme mundëson fiksimin e sistemit përgjatë parapetit të betonit. Ky element i përshtatur posaçërisht për t'i rezistuar ndryshimeve të kushteve klimatike, mundëson largimin e ujit duke mos e lejuar të kalojë në brendësi të strukturës së objektit.

.....

ALUMINIUM SEAL

The aluminum alloy is the element that realizes the joining between the waterproofing system and the thermal insulation of the facade. Its suitable material and shape enable fixing of the system along the concrete parapet. This specially adapted element to withstand changes in climatic conditions allows the removal of water without allowing it to pass through the structure of the facility.




TRANSFORMATOR


Transformator i thatë me rezinë. Transformatorët janë me tension 20 kV, me dredha spirale primare të dyfishta dhe dredha spirale sekondare 0.4 kV. Ata janë të vendosur në ambiente të veçanta dhe janë të mbyllur në kafaz me fleta çeliku, me shkallë të mbrojtjes IP31, si dhe janë të lidhur me kuadrin e përgjithshëm të tensionit të ulët nga zbarra elektrike.

POWER TRANSFORMER

Dry resin transformer. Transformers are 20 kV voltage with primary winding and secondary 0.4 kV winding. The transformers placed in particular environments closed in steel sheets cages IP31 protected. The transformers linked to the general low voltage distribution board with electrical busbars.



A1	1390.0mm
B1	820.0mm
H1	1330.0mm
e	520mm (100–250 kVA) 670mm (315–800 kVA) 820mm (1000–1600 kVA) 1070mm (2000–2500 kVA)




MATËSA ELEKTRIK

Matësat elektrikë janë të gjithë matësa elektronike. Ata mund të jenë matësa tri fazorë (zakonisht për bizneset) dhe matësa një fazor (zakonisht për abonentët familjarë). Matësat elektrikë janë inkasuar në panele metalike, të cilat janë gjithmonë të pozicionuara në katin përdhes dhe pranë shkallës.

ELECTRICAL ENERGY METER

Electrical measurers are all electronic measures. They can be 3 phase measurers (usually in businesses), and 1 phase measurers (usually in familiar environments) electrical measurers encased in electrical panels. Metallic panels always placed on the ground floor near the stairs.

PANELET E MATJES SE PERQENDRUAR TE ENERGJISE ELEKTRIKE TE APARTAMENTEVE SEKSIONI 1,2 (PM1,PM2).



ÇELËSA DHE PRIZA



Kutitë plastike të cilat shërbejnë për fiksimin e çelësave dhe prizave, janë të vendosura brenda murit. Të gjithë çelësat janë: on/off, të thjeshtë, devijat apo inverter, si dhe pulsantet e komandimit janë 10A, 220V. Të gjithë çelësat që janë 400V dhe 230V, me ngarkesa më shumë se 10A janë të tipit CEE sipas ngarkesës së kërkuar.

SWITCHES, PLUGS





Plastic boxes which serve to keep the switches and receptacles fixed placed inside the wall. All on/off switches, deviant and inverter series, as well as command buttons, are 10A, 220V. All required receivables are generally duplex-type.

SKEMA KOMANDIMIT TE NDRICIMIT

SKEMA E KOMANDIMIT TE NDRICIMIT DEVIATOR



SKEMA E KOMANDIMIT TE NDRICIMIT TE SHKALLEVE



NDRIÇUES BRENDA


Në katet -1 janë përdorur ndriçues linear 2x36 flouroshent, ose ndriçues LED. Sasia e ndriçuesve është e tillë, që të kapen normat e fluksit të ndriçimit rreth 150 lux. Ndriçuesit në katet -1 mund të jenë të fiksuar në tavan me prozheniere, ose mund të jenë të fiksuar në kanalinat metalike. Në të gjitha rastet ndriçuesit instalohen jashtë murit dhe janë linear.

.....


INTERIOR LIGHTING

In the underground floor are used linear 2x36 fluorescent or LED lighters. Lighter quantity specified according to reach the flux rates, at around 150 lux. -1 floor lighters fixed in the ceiling with threaded rod or in metallic channels. In all of the cases, the lights are linear and installed out of the wall.



Detaj 1



Detaj 2



Detaj 3



TELEFON / TV / INTERNET


Në të gjithë apartamentet nuk mungojnë sinjalet e internetit, telefonit, televizorit dhe citofonisë. Për sinjalin e internetit është përdorur kabëll FTP Cat 6 dhe prizë RJ45. Për sinjalin telefonik është përdorur kabëll UTP Cat 5 dhe prizë RJ45. Për sinjalin televiziv tokësor dhe satelitor është përdorur kabëll RG59.

.....

PHONE TV INTERNET

Every apartment equipped with internet, telephone, television and intercoms signals. It used an FTP Cat 6 cable and RJ45 sockets for the internet signal. It used a UTP Cat 5 cable and RJ45 plugs for telephone signals and used as an RG59 cable for the satellite and television signals.

Detaj i prizave te Tv ne sallon



Detaj i prizave tek koka krevatit






RRUFEPRITËS

Të gjitha tarracat e pallateve mbrohen nga shkarkimet atmosferike. Në të gjithë tarracat e ndërtesave janë shtruar shirita zinku me përmasa 30x3 mm. Tek të gjitha pajisjet metalike, komponentët më të gjatë se 1 m janë të lidhur me sistemin e mbrojtjes rrufepritesë. Të gjithë objektet më të larta se sipërfaqja e kulmit janë të mbrojtura tërthor me shufra vertikale.

.....

LIGHTNING ROD

All buildings ceiling protected by atmospheric emissions and objects are higher than the roof. All terraces covered by 30x3 mm zinc strips. All mechanical types of equipment, components more extended than 1 m linked to a lightning rod protection system.





UJI FURNIZIM

Në impiantin e furnizimit me ujë të apartamenteve një rëndësi të veçantë ka skema se si furnizohen këto apartamente dhe materiali i përdorur për këtë impiant. Skema që është përdorur për këtë impiant është e tillë: Linja e furnizimit nga rrjeti urban furnizon depot e ujit, me anë të pompave e dërgojmë ujin në linjën kryesore të furnizimit të grupit të kontraktorëve dhe më pas me linja të veçanta furnizohet çdo apartament.

WATER SUPPLY

In the apartment water supply plant, there is a scheme of how these apartments and the material used for this furniture supplied. The system used for this furniture is, the supply line from the urban network provides the water repositorys, by pumping the water to the main supply line of the group of contractors and then with separate lines is supplied to each apartment.




MATËSA

Grupi i kontatorëve është “kolektori” që furnizohet me ujë nga stacioni i pompimit dhe më pas nga grupi i kontatorëve bëhet furnizimi me linja të veçanta për çdo konsumator. Nëpërmjet këtij grupi bëhet komandimi i presionit, mbyllja e ujit në rast difekti, pa shkaktuar ndërprerje tek apartamentet e tjera. Në rast të difekteve (rrjedhjeve) të këtij grupi nuk dëmtohet asgjë, siç ndodh me sistemin klasik që rrjedhja e ujit bëhet nëpër shkallet e pallateve. Gjithashtu kontrolli nga faturistët e UKT-së bëhet më i lehtë, pa patur nevojë që ata të futen brenda ambienteve të banimit.

.....

GROUP CONTRACTORS

The group of controls is a “collector” that is supplied with water from the pumping station and then from the group of the commands provided with separate lines for each customer. Through this group, pressure control performed, water closure in case of defect, without causing interruption to other apartments. In the event of the errors of this group, nothing is harmed, as is the case with the classical system that the flow of water takes place on the stairs of the palaces. Controlling from UKT bills makes it easier, without having to enter the residential premises.




MKZ

Rrjeti i jashtëm i furnizimit me ujë të kompleksit është projektuar me rrjet unazor, që do të thotë se godinat furnizohen me dy rrjete. Ky rrjet është i qëndrueshëm ndaj humbjeve të presionit dhe në rast se njëra nga linjat pëson difekt, godina furnizohet me ujë nga linja tjetër. Në këtë rrjet janë montuar edhe hidrantët e zjarrit nëntokësor, që në raste zjarri, autozjarrfikëset furnizohen me ujë në këto hidrantë pa patur nevojë të kthehen në bazë për t'u rimbushur.

FIREPROOF SYSTEM

The external water supply network of the complex is designed with a ring connection, which means that the buildings are supplied with two systems. This network is resistant to pressure losses and if one of the lines is defective, water is provided by the other line. In this network are also installed underground fire hydrants, which in case of fire, the auto switches are supplied with water in these hydrants without having to return to the base for refueling.




SHKARKIMI I UJRAVE TË ZEZA

Shkarkimi i pajisjeve është ndërtuar duke përdorur tuba PP, me gota me gominë dhe duke mbajtur diametrin dhe pjerrtësinë sipas standardeve europiane. Tubat e shkarkimit pasi dalin nga pajisja, shtrihen në shtresën e dyshemesë dhe lidhen me kolonën vertikale të shkarkimeve, e cila është ndërtuar me kolonë balancimi për të kryer një funksionim sa më të mirë të këtij sistemi.

.....

OUTLET SANITARY APPLIANCES

Discharge of the equipment is built using PP tubes with rubber cups, holding diameters and slopes according to European standards. The discharge tubes after they exit the appliance lie on the floor layer and connected to the vertical discharge column that is built with a balancing column to make the system work better.




AJRIMI

Impianti i ventilimit të kuzhinave është konsideruar si një element shumë i rëndësishëm për kompaninë Kontakt. Ky impiant është delikat nga pikëpamja e problemeve që mund të shkaktojnë aromat e kuzhinave në ambientet e banimit dhe në apartamentet e të njëjtës godinë.

.....

VENTILATION SHAFT

The kitchen ventilation system is one of the most significant residential buildings. This equipment is delicate from the problems that can be caused by kitchen fragrances in the residential apartments of the same building.



KUZ

Rrjeti i jashtëm i ujërave të zeza është ndërtuar për mbledhjen e ujërave të përdorur, që vijnë nga kolonat e shkarkimit të ambienteve sanitare dhe për t'i shkarkuar ato në rrjetin urban të ujërave të zeza. Materiali që është përdorur për këto tuba është polietilen i rrudhosur, që plotëson të gjitha kërkesat e cilësisë, të çertifikuar sipas standardeve europiane për ujërat e zeza.

EXTERNAL SWEAGE NETWORK

The external sewerage network is built for the collection of wastewater from the discharge columns of the sanitary facilities and to be discharged into the urban wastewater network. The materials used for these tubes are enameled polyethylene that meets all quality requirements certified according to European standards for sewage.




KUB

Për kullimin e ujërave sipërfaqësor do të përdoret sistem linear i kullimit. Termi "linear" përdoret për të theksuar natyrën sipërfaqësore të kullimit të kanaleve. Kanalinat e kullimit janë një pikë kyçe në menaxhimin e ujërave sipërfaqësorë dhe ky menaxhim duhet kryer me kujdes dhe në mënyrë të duhur.

EXTERNAL RAINWATER SYSTEM

For drainage of surface water will be used a linear drainage system, the linear term is used to emphasize the surface nature of waste of channels. Drainage channels are a vital point in surface water management and should be managed carefully and correctly.





HIDROIZOLIM NËNTOKË

Hidroizolimi i mureve perimetrale të nëntokës realizohet me primer në trajtë boje. Aplikimi i primerit realizohet me një shtresë dhe kontrollon në pika kritike me anë të një ruli të thatë për të eliminuar zonat me shumë primer. Tregohet kujdes në aplikim të ketij primeri në detajet e tubave të shkarkimit dhe në këndet e objektit, si dhe realizohet tharja në kushte normale klimatike. Pas përfundimit të hidroizolimit dhe vendosjes së tubit të drenazhimit për largimin e ujërave në këto zona, realizohet mbushja e hapësirave me dhe.

UNDERGROUND WATERPROOFING

Hydrosilylation of the perimeter walls of the underlayer is carried out with primer in the paint formulation. Primer application is performed with a layer and checked at critical points using a dry roller to eliminate more primer areas. Attention is drawn to the application of this primer to the details of the discharge pipes and the spaces of the object, and drying is carried out under normal climatic conditions. After the waterproofing and laying of the drainage pipe for the removal of the waters in these areas, the filling of the soil spaces realized.





HIDROIZOLIM TUALETE

Në tualete, ku kondensimi është faktori kryesor për krijimin e lagështisë, realizohet hidroizolimi në dysheme dhe në muraturë. Pas veshjes së hapësirës me shiritin e posaçëm, aplikohet masa hidroizoluese në trajtë boje në të gjithë sipërfaqen e dyshemesë, si dhe në perimetër të hapësirës. Në pozicionet e hidrosanitareve aplikohet hidroizolim në lartësi, i cili respekton pozicionin specifik, nga ku secila pajisje furnizohet me ujë. Pas aplikimit të paketës hidroizoluese realizohet veshja dhe shtrimi i tualetit me pllaka.

TOILET WATERPROOF

In the toilets where condensation is the main factor for the creation of moisture, waterproofing is performed on the floor and in the masonry. After covering the space with the special ribbon, apply watercolor paint masses on the entire surface of the level as well as on the perimeter of the area. In the position of the sanitary units, waterproofing applied to the height which respects the specific position from which each device supplied with water. After implementing the waterproofing package, the dressing and paving of the tiled bathroom realized.




HIDROIZOLIM TARRACA

Tarraca është një nga pikat më të dobëta ndaj lagështisë në dimër apo mbinxehjes në verë, për shkak të ekspozimit të vazhdueshëm ndaj agjentëve atmosferikë. Hidroizolimi që aplikohet në tarracë respekton kushtet teknike, duke u mbështetur në faktoret klimatike specifike sipas zonës ku ne ndërtojmë. Aplikimi i sistemit me membranë sintetike, detaje të parapërgatitura, fletë metalike të veshura dhe materiale ndihmëse realizojnë lidhjen e nevojshme me hidroizolimn nëntokë dhe termoizolimn e fasadës. Paketa hidroizoluese aplikohet horizontalisht dhe vertikalisht në të gjithë perimetrin e këtyre hapësirave, duke krijuar barrierën e nevojshme ndaj agjentëve atmosferikë.

ROOF WATERPROOFING

The terrace is one of the weakest points to winter humidity or overheating in the summer because of the constant exposure to atmospheric agents. The waterproofing applied to the gardens respects the technical conditions by relying on the climatic factors due to the area where we constructed. Application of the synthetic membrane system, prefabricated details, coated metal sheets, and supporting materials realize the necessary bond with the underground waterproofing and thermal insulation of the facade. The waterproofing package is applied horizontally and vertically across the perimeter of these spaces by creating the necessary barrier to the atmospheric agents.






SISTEMIMI I JASHTËM • external facilities

RRUGË AUTOMJETE

Pruga e emergjencës përbëhet nga akse të projektuara për lëvizjen e mjeteve të zjarrfikëses, ambulancës dhe shërbime të tjera në funksion të sigurisë së jetës. Rruga unazore shërben si rrugë emergjence për aksesin perimetral të objekteve, ndërsa dy "Spinet" kryesore për depërtimin e saj në brendësi të objektit.

VEHICLES ROUTE

The emergency road consists of axes designed for the movement of firefighters, ambulances and other services in the function of life security. The ring road serves as an emergency route for the perimeter access of the objects as well as two main spinets for its penetration inside the facility.



1 A-18-021-1 SECTION
SCALE: 1:20




RRUGË KËMBESORE

Rrugët këmbësore janë të projektuara në flukset e kalimit, në afërsi të hyrjes së objekteve, si një formë lidhëse mes oborreve dhe shesheve të kompleksit. Ato janë të shtruara me pllaka 48 mm, me dimensione 60x40 cm ose 40x40 cm, me ngjyrë gri dhe rozë, duke krijuar një gjeometri estetike në plan, por dhe funksionale në aspektin e orientimit të flukseve.



.....

WALKWAY

Footpaths are designed in flow paths, near the entrances to objects, as a connecting form between the yards, the squares of the complex. They laid with 48 mm tiles, 60x40 cm or 40x40 cm in size, gray and pink, creating an aesthetic geometric design but functional in terms of flow orientation.



2 SECTION
SCALE: 1:50




FISKULTURË

Prej kohësh mjetet e fiskulturës janë kthyer në një formë apo në një tjetër në të pazevëndësueshme. Kontakt gjen gjithmonë formën për t'i sjellë ato në rezidencat e banimit, si të ndërthurura me këndet e lojrave, por edhe për ushtrimin e grupmoshave më të mëdha.

.....

SPORT AREA

Sport types of equipment have long been in a form or other irreplaceable form. Nevertheless, Kontakt always finds the way to bring them into residences, as intertwined with the playground areas as well as for the elder age group to exercise.





BIÇIKLETA

Mbajtëset për parkimin e biçikletave në sistemimet e jashtme të Kontakt janë lehtësisht të identifikueshme, pasi kanë një stil tejet minimalist. Ato janë realizuar me skelet metalik dhe arrijnë lartësinë 80 cm.

.....

BICYCLE HOLDERS

You can quickly identify on the outdoor landscape the bicycle parking spots that Kontakt has to offer, and they have a minimalist and simple style. The frames made of metal and they reach a maximum height of 80 cm.




STOLA

Stolat në sistemimet e jashtme të Kontakt janë lehtësisht të identifikueshëm për finesën dhe dizajnin e tyre të personalizuar. Ato kanë në përmbajtjen e tyre 2 materiale kryesore: metalin dhe drurin. Skeleti metalik i ndërthurur me materialin e drurit i sjell KONTAKT-it një pjesë të postmodernizimit.

BENCHES

The benches in the external Kontakt systems are easily identifiable for the finesse and their personalized design. They have in their content 2 main materials: metal and wood. Metal skeleton with wood material brings a part of postmodernism in Kontakt.



INSTALACION

Parimi i konceptit të instalacionit bazohet në formën më të madhe të kamerës të ndërtuar ndonjëherë nga George R. Lawrence (1906). Kamerat e atëhershme janë të ndërtuara nga disa dhomëza me faqe paralele me njëra-tjetrën. Këto dhomëza janë rrotulluar me 15° në çdo rast dhe faqet lidhëse të tyre kanë krijuar formën organike që është ilustruar. Instalacioni do të ketë si funksion të tregojë me një fokusim të thjeshtë fokusimin drejt një objekti ose zone (në varësi të pozicionit të instalacionit).


INSTALLATION

The principle of the installation concept is based on the most significant form of a camera ever built by George R. Lawrence (1906). The cameras mentioned above are made from several chambers parallel to each other. In this case, these rooms have been rotated by 15° in each case and their binding sites have created the organic form that presented. The installation will have the feature to show with a simple focus an object or area (depending on the installation position).

Strukture metalike (hekur) 4cm x 4 cm.
Strukture e trajtuar me astar kunder ndryshkut dhe me pas lyerje me pjekje.

KODI RAL : RAL 9004


Pjeset e struktures do te lidhen me njera tjetren me shufra nga brenda dhe do te trajtohen me te njejten ngjyre per te mos u perceptuar.



Llamarine e zinkuar me spesor 1mm.

Ne pjesen e brendshme trajtim me pjekje (KODI RAL : RAL 7021)

Pjesa e jashtme e smeriluar dhe me shkelqim per tu lexuar me teper faqet e lakuara.




Llamarina me strukturen do te fiksohet me saldime ose me percina.

Strukture metalike (hekur) 4cm x 4 cm ose profil me i madh ne varesi te nevojës per qendrueshmeri. Kembet do te trajtohen njelloj si struktura.




KODI RAL : RAL 9004

Lidhja e kembeve me strukturen do te behet me saldime ndersa me bazamentin e betonit me inkastrim.



Bazamenti eshte supozuar nje bllok betoni per arsye se mungon informacioni i vendodhjes se parashikuar te instalacionit.

Bazamenti do jet prej betoni me armim minimal per te bere lidhjen e kembeve me bazamentin.



GJELBËRIM

Në mënyrë që zonat e rekreacionit të jenë ftuese dhe të gjallëruara në çdo stinë të vitit, është e nevojshme që këto nevoja të krijohen dhe plotësohen me anë të sistemimit të jashtëm për banorët e zonës. Për të pasur një zonë rekreative e cila të fton të shpenzosh më shumë kohë, një pikë mjaft e rëndësishme është gjelbërimi. Ajo që është marrë parasysh në krijimin e ambienteve të gjelbërimit nga Kontakt janë kombinimi që ju është bërë bimëve drusore me shkurret dhe bimëve gjetherënëse me ato gjethembajtëse. Këto mundësojnë që në çdo stinë të vitit ambientet të mos jenë të zhveshura nga gjethet.

GREENERY

For the recreation areas to be inviting and enlivened every season of the year it is necessary for us to complete these needs by creating external accommodation for the residents of the city. To have a recreation area that invites you to spend more time in it, a very significant point is how we combine trees and shrubs. What has taken into consideration in creating green spaces by Kontakt is the combination of bushy tree plants and unleafy leaves with leaf leaves, which make it possible for every season of the year that the area is not without leaves.





PARKIM

Në hyrje të parkimit janë pozicionuar cilindrat bllokues, të cilët lejojnë aksesin e banorëve për në vendparkimet e tyre. Katër cilindra me diameter 20 cm, të cilat ngrihen deri në lartësinë 50 cm, komandohen me pulse nga banorët duke u ofruar komoditet maksimal në përdorimin e pronës së tyre.

PARKING

At the entrance of the parking are the locking cylinders, which allow residents to access their parking spaces. 4 cylinders with a diameter of 20 cm, which raised to a height of 50 cm, are controlled by the residents, offering maximum comfort in the use of their property.



Cilindri, pjesa e jashtme

Cilindri, pjesa nen toke
Foleja mbeshtetese







Të ndërtosh është më shumë sesa duket...

